

# Hylli i Dritës

*Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.*

(-II ad Cor. III, 17-)

|  |          |
|--|----------|
| 1. Ipeshkvijt e Shqypnis e çashtja e<br>zgjedhjeve | Faqe 529 |
| 2. Permbi zgjedhjet per Kuvendin kushtetues        | 538      |
| 3. Influenca e çfutenve në socializem              | 543      |
| 4. Shqipëria dhe Shoqëria e Kombevet               | 546      |
| 5. Rezultati i zgjedhjeve n' Austri                | 554      |
| 6. Kanûni i Lekë Dukagjinit                        | 559      |
| 7. Lajme   | 564      |
| 8. Bibljografi                                     | 568      |

## Posta e jonë.

**Pajtimtarëve.** — Disave, një pakicës që duket se nuk i ka para sysh flitë që, sidomos ekonomikisht do të bëjë një Redakcion për me majtë një të Perkohëshme si është kjo e jona, u thona edhe një herë se vonesa e tyre në të paguen është një dam të cillin ata na sjellin, e që ka me na shterngue me jau kputë dergimin e Hyllit të Dritës për mas tashit, po s'u pajtuene me parë në dorë.

**Gjirokastrë. M. G.** — Tuj dishmue se muerem pajtimin e vjetës 1923, u falena nderës prej zëmret e u lutena të na rrini besnik edhe mas tashit.

**Tiranë. K. A. D.** — Por sa muerem letren t'uej kemi pasë kujdes me pvetë në zyren e dergimit e cilla na njoftoj se kolekcionin, si mas dishirit, jau kishte dergue me postë.

**Durrës. K. D.** — Po çuditena për ploshtësi për të cillen na bisedoni në leter. Do të veprojmë njashtu si na lajmuet.

**Troshan. P. B.** Dorëshkrimin tjetër e muerem, si jau dishmon vetë ky Numer i së Perkohëshmes s'onë. U falena nderës e u dergojmë shumë shndet.

**Athinë. M. Fr.** Letren e parë me dorëshkrim e muerem e me kohë na ra edhe e dyta, kshtu që, si mund shofë edhe Zotnija e Juej vetë, ndreqem çka ishte me u ndreqë. U falena nderës me zëmer.

# HYLLI I DRITËS

Vjeta IV.

DHETUER 1923

Numri XII.

## **Ipeshkvijt e Shqypnis e çashtja e zgiedhjeve.**

Me 30 Tetuer të k. v. të Perndritshemt Zotni Arqipeshkvij e Ipeshkvij katolikë të Shqypnis i kan shpallë klerit e popullit katolik shqyptar një leter çarkore mbi çashtjen e zgiedhjeve per Assemblën Konstituente.

Në ket leter të Perndritshemt e të Pernderueshemt Zotni, mbasi një herë kan folë mbi mndyrë të zgiedhjeve, mbi randsi të madhe të ktyne zgiedhjeve e mbi detyrë qi, si në pikpamje fetare si n'atë atdhetare, kan katolikët me u organizue, abolla zgiedhjet të dalin sa mâ të dobishme per Fë e Atdhë, i lajmojnë klerit e popullit të vet, se atà kan me u shpallë „listen e atyne njerzve qi në ndergjegje të vet i shofin para Zotit t'aftë me na perfaqsome në Kuvend Kushtetues“, edhë u thonë, se detyra e secillit katolik àsht me e pranue e me e perkrahë ket listë.

Del, tash, fletorja „Vilaznija“, qi botohet ktû në Shkoder, e në Nr. 6. të vetin bjen një artikull, të nenshkruem me siglen L, në të cillin, mbasi àsht permendë çarkorja e Zotnive t'onë të Ndrishtem, thohet: „At-herë pra per të pasë me bâ kshtû edhë kleri muhamedan e Ortodoks ç'ka kishte per të ndollë?“ e prej se me giasë, as shkruesi vetë nuk dite shka do të ndollte, pvetet prap: „a àsht mirë kshtû? .... pra na jem per kundra kësaj: na

jemë mendimit qi populli të lëshet i lirë prej klerit të ti me votue per kë ati t'i duket se është më mirë e më me dobi.“

Artikuj kso dore jo veç se nuk duen marrë në kujdes prej nesh, por janë më teper një turp per marë shtypin komtar. Mbrendë nuk kë as idë, as gjuhë e shka është edhe më zi, s'kë as at lidhnin logjike ndermjet fjalve, pa të cillen s'mund të kuptohet se shka do me thanë folsi a shkruesi. Me gjith kta s'po na bëhet me ndëjë pa ja ngrëfë pak veshin ktij z. L. per me ja shtë në trû, se aj nuk kë kerrçik me u vûe kundra e me qitë poshtë me arsyë aktet e Episkopatit katolik shqyptar. Hane njeri, të cillit i vjen marre me zanë në gojë dër emnin e vet, e hane l'peshk-vijt e Shqypnis!

\* \* \*

Thotë pra ky zotni L.: „At-herë pra per të pasë me bân kshtû edhe kleri muhamedan e Ortodoks çka kishte per të ndollë?“ Kurrgjâ s'kishte me ndollë. Shum shum me thënë, kishte me ndollë kta, qi kandidat e listës s'ndonji tjetrit komitat — po e zâmë, t'atij të „Vllaznis Popullore“ — ditën e zgjedhjeve kishin me u dâ me një grusht miza, e se prandej, ndoshta, per nja dyë a trië dit do t'u bite me ndejë ndrye në shpi, per me blue vnerin e zëmërs, edhe me shpenzue ndonji koronë të shkretë të ezaxhija a se barnatari. Po, por, sa per kaq nuk bëhet gazepi: a dro po shamet Roma? Pra bashkpuntori i „Vllaznis“ mundet me fjetë rahat, pse po i bânëmi dorzanë na, qi kurrgjâ të keq s'kishte me i ndollë Shqypnis per ket punë. Veç. po, mundet, ndoshta, me kënë, se atij do t'i prishej qefi, me pasë per të ngelë në baltë ditën e elekcjoneve kandidat e listës s'njanit a të tjetrit komitat, qi mos t'jët kleri; por qefi është një punë e veçantë e jo e Shqypnis. Prandej, pse t'i priset qefi atij, kë e s'ka ndojsend: veç gjâ me i

